



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:016315

Datë: 19.07.2019

Numri i dokumentit: 00418585

P.nr. 327/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka me Sek. Juridike Vjollca Haziraj në lëndën penale PP/II.nr.726-8/18 të datës 20.07.2018, ndaj të pandehurit I. H. nga fsh. B. Komuna S, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 i Kodit Penal, duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren, në prezencën e P.Sh. Musli Gashi dhe të akuzuarit, me datën 17.07.2019 mori, publikisht shpalli dhe me datë 19.07.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I Akuzuari I. H i lindur më, i biri i S. H. dhe nënës A. H. e lindur B, me vendbanim në fsh. B. komuna S, i gjendjes së mesme, i martuar, ka te kryer shkollën e mesme, profesioni mekanik, shqiptar shtetas i R. se Kosovës. I pa dënuar më parë, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me date 30.09.2016 rrrth orës 17.50 minuta, saktësisht ne fshatin B. komuna S i pandehuri I. H duke drejtuar automjetin e markës “H”, ngjyre e zeze, me targa 04-...-EN, nga pakujdesia e ne kundërshtim me nenin 53 dhe 151 te Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, ka rrezikuar pjesëmarrësit ne komunikacion dhe ka vu ne rrezik jetën e njerëzve, ne atë mënyrë qe duke mos e përshtatur mënyrën e lëvizjes dhe kushteve te krijuara ne komunikacion, e sidomos mos pasur kujdes ndaj pjesëtarëve te veçantë ne komunikacion-fëmijës J. L. me triçiklet (plastike) qe ishte duke lëvizur ne rreth rrotullim dhe ne kahe te kundërt te lëvizjes nga na e majte, i pandehuri I. H. nuk paraqet kujdesin e duhur ne mënyrë qe te ndaloj veturën, ashtu qe te dëmtuarin e godet me pjesën e përparme anësore te anës se majte te veturës, me ç rast te dëmtuarit i shkakton lëndime te renda trupore, lëndime këto te konstatuara nga eksperti mjeko-ligjor dr. Flamur Blakaj.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 te KP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 46, 51, 52, 73, 74, të KP-së, si dhe nenit 359 par. 1 dhe 2 dhe nenit 365 të KPP-së, i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Duke ia caktuar dënimin me burgim prej prej tetë (8) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse ne kohën e verifikimit prej dy viteve, i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te shpenzimeve te ekspertizës se komunikacionit te paguaj shumen prej 40.88 euro, ne emër te ekspertizës mjeko-ligjore shumen prej 20 euro, ne

emër te kompensimit te viktimave te krimit 30 euro, si dhe paushallin gjyqësor ne shume prej 20 euro, te gjitha këto pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Udhëzohen palët e dëmtuara: J L nga fsh. B Komuna S përmes përfaqësuesit ligjor, qe kërkesën pasurore-juridike, ta realizoj ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH. nga Prizreni me aktakuzën PP/II.nr.726-8/18 të datës 20.07.2018, ndaj të pandehurit I H nga fsh.BI komuna S, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 i Kodit Penal, duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren, aktakuzën të cilën gjate seancës gjyqësore e ka përfaqësuar PSH ne Prizren Musli Gashi, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimet te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH-se ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin gjyqësor nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-se, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 te KPK-së, andaj Gjykata ka vendosur se i akuzuari është fajtor dhe i shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-se, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, ka pranuar fajësinë ne mënyrë vullnetare, veprën penale nuk e ka kryer me dashje por nga pakujdesia, kurse rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti. me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm që veprime të tilla apo të ngjashme të mos përsëriten.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-se.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori ne kuptim te nenit 452 par.1 te KPP.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

G j y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.